


# Aksidentet Rrugore

## Nëntor 2021

**Tiranë, më 17 Dhjetor 2021:** Në muajin Nëntor 2021 numërohen 106 aksidente rrugore nga 110 aksidente të ndodhura në muajin Nëntor 2020, duke u ulur me 3,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021 numërohen 1.257 aksidente rrugore nga 1.121 aksidente të ndodhura në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, duke u rritur me 12,1 %. Krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, numri i aksidenteve është ulur 7,8 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Nëntor 2017 – Nëntor 2021



**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në muajin Nëntor 2021, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 156 persona nga 139 që ishte në të njëjtën muaj të një viti më parë. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, numri i të aksidentuarve është 1.726 persona nga 1.451 persona në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, numri i të aksidentuarve ka qënë 1.857 persona.

Në muajin Nëntor 2021, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 11 persona, nga 15 persona të vdekur në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 176 persona nga 168 persona të vdekur në të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe nga 203 persona të vdekur në po të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në muajin Nëntor 2021, aksidentet rrugore, në 85,8 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 25–34 vjeç, duke zënë 23,6 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup-moshë janë ulur me 10,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, aksidentet rrugore, në 15,4 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është rritur 22,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur me 6,8 %.

**Tab. 1 Aksidentet rrugore dhe numri i të aksidentuarve sipas gjinisë**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Nëntor 2020	110	6	9	36	88	
Nëntor 2021	106	2	9	50	95	
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-3,6</b>	<b>-66,7</b>	<b>0,0</b>	<b>38,9</b>	<b>8,0</b>	
Janar-Nëntor 2019	1.363	54	149	496	1.158	
Janar-Nëntor 2020	1.121	37	131	380	903	
Janar-Nëntor 2021	1.257	40	136	503	1.047	
<b>Ndryshimi vjetor progresiv 2021/2020 (%)</b>	<b>12,1</b>	<b>8,1</b>	<b>3,8</b>	<b>32,4</b>	<b>15,9</b>	

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 2 Aksidentet rrugore sipas përdoruesve të rrugës**

Periudha	Aksidentet sipas		Të vdekur	
	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit
Nëntor 2020	95	15	15	0
Nëntor 2021	91	15	11	0
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-4,2</b>	<b>0,0</b>	<b>-26,7</b>	<b>—</b>
Janar-Nëntor 2019	1.156	207	176	27
Janar-Nëntor 2020	963	158	154	14
Janar-Nëntor 2021	1.064	193	151	25
<b>Ndryshimi vjetor progresiv 2021/2020 (%)</b>	<b>10,5</b>	<b>22,2</b>	<b>-1,9</b>	<b>78,6</b>

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit**

Periudha	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Nëntor 2020	22	28	23	17	10	10
Nëntor 2021	21	25	17	24	10	9
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-4,5</b>	<b>-10,7</b>	<b>-26,1</b>	<b>41,2</b>	<b>0,0</b>	<b>-10,0</b>
Janar-Nëntor 2019	282	406	237	265	107	66
Janar-Nëntor 2020	177	336	193	237	109	69
Janar-Nëntor 2021	271	341	226	226	118	75
<b>Ndryshimi vjetor progresiv 2021/2020 (%)</b>	<b>53,1</b>	<b>1,5</b>	<b>17,1</b>	<b>-4,6</b>	<b>8,3</b>	<b>8,7</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 4 Aksidentet rrugore dhe numri i të vdekurve sipas qarqeve**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur			
	Nëntor 2020	Nëntor 2021	Nëntor 2020	Nëntor 2021	Janar-Nëntor 2019	Janar-Nëntor 2020	Janar-Nëntor 2021	Janar-Nëntor 2019	Janar-Nëntor 2020	Janar-Nëntor 2021
<b>Shqipëria</b>	<b>110</b>	<b>106</b>	<b>15</b>	<b>11</b>	<b>1363</b>	<b>1,121</b>	<b>1257</b>	<b>203</b>	<b>168</b>	<b>176</b>
Berat	2	3	0	0	23	11	28	3	7	2
Dibër	4	1	0	0	14	50	20	6	3	4
Durrës	10	9	4	3	115	108	105	32	28	20
Elbasan	5	1	1	0	78	57	53	21	21	21
Fier	10	9	2	2	121	83	109	31	21	27
Gjirokastrë	8	7	0	0	56	41	80	3	5	9
Korçë	8	3	1	0	102	70	53	15	6	8
Kukës	4	6	1	0	33	27	47	5	5	2
Lezhë	11	11	3	1	146	111	159	18	20	24
Shkodër	3	2	1	2	21	24	23	16	14	14
Tiranë	44	54	2	3	583	518	563	46	31	32
Vlorë	1	0	0	0	71	21	17	7	7	13

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimin në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

## Përkufizime

**Aksidente:** Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

**Aksident me pasoja:** Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

**I vdekur:** Çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, përjashtuar vetëvrasjet.

**I plagosur:** Çdo person i cili si rezultat i një aksidenti nuk u vra menjëherë ose nuk vdiq brenda 30 ditësh, por pësoi një dëmtim për të cilin lind nevoja e një trajtimi mjekësor, duke përjashtuar vetëvrasjet në përpjekje.

**Sjellja e Drejtuesit të Mjetit:** Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.

**Sjellja e Këmbësorëve:** Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: kalim rruge pa kujdes, etj.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

*Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).*

## Shpjegimi i simboleve

- 0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- pa vlerë
- (...) mungesë të dhënash